REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 6523/17 Prot.

Sarandë, më 02.09.2025

PROÇESVERBAL

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Sarandë që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:00
Data e mbajtjes së mbledhjes : 29.08.2025
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Sarandë: N/Kryetare e Bashkisë Zj.Irena Marjani dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen.

Marrin pjesë :

1. Asaf Stroka
2. Gjergji Imeraj
3. Lindita Kondi
4. Denisa Islamaj
5. Festim Mina
6. Ermir Hoxha
7. Dafina Allkushi
8. Katerina Beqo
9. Zana Piro
10. Bejdo Çela
11. Xhino Jaçaj
12. Kevin Alikaj
13. Klejdjan Murtaj
14. Përparim Ahmeti
15. Eugen Qëndro
16. Elona Mano
17. Laureta Çeçi

Mungojnë :

18. Ilva Qëndro
19. Vesel Koçiu
20. Ibrahim Bajrami
21. Angjele Lapa
22. Ilirjan Gërdhuqi
23. Farie Hyska
24. Enea Vasili
25. Dritan Peçi
26. Indi Rrapaj
27. Pranvera Osmani
28. Shpëtim Ahmeti
29. Thanas Gurma
30. Anjeza Dike

Asaf Stroka : Përshëndetje !
Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak! I nderuar Zv/Kryetar i Bashkisë!Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të medias !
Zhvillojmë mbedhjen e Këshillit Bashkiak datë 29.08.2025, vijojmë bazuar në ligjin 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, çdo fillim mbledhje miratohet rendi i ditës sipas thirrjes për zhvillimin e mbledhjes sipas rendit si më poshtë:

1. **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin Korrik 2025".

2. **P/vendim**"Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Korrik 2025".

3. **P/vendim**"Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe këshillit të ministrave të republikës së shqipërisë për rritjen e kapaciteteve te qeverisjes vendore, akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të republikës së shqipërisë (talga)".

4. **P/vendim** "Për miratimin e planit social vendor 2026-2028 të Bashkisë Sarandë" .

5. **P/vendim** " Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar 2026-2028 të Bashkisë Sarandë".

6. **P/vendim** "Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2025-2030".

7. **P/vendim** "Për miratimin e planit të integritetit të Bashkisë Sarandë 2026-2028".

8. **P/vendim** " Miratim i korrigjimit të gabimeve materiale".

9. Informacion për masat e marra për fillimin e vitit shkollor 2025-2026.

Gjergji Imeraj: Propozoj të shtohet në rendin e ditës projektvendimi " Për një ndryshim në buxhetin e ndërrmarjes së shërbimeve publike Bashkia Sarandë për vitin 2025".

Asaf Stroka: Hedhim në votim rendin e ditës me propozimin e bërë nga zoti.Imeraj

Miratohet me 17 vota pro rendi i ditës me propozimin e bërë nga Z.Imeraj.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin Korrik 2025".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: **P/vendim** "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Korrik 2025".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës**: P/vendim** "Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe këshillit të ministrave të republikës së shqipërisë për rritjen e kapaciteteve te qeverisjes vendore, akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të republikës së shqipërisë (talga)".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.
Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e katërt të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e planit social vendor 2026-2028 të Bashkisë Sarandë" .

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e pestë të rendit të ditës: **P/vendim** " Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar 2026-2028 të Bashkisë Sarandë".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2025-2030".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 6 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga këshilltarët?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e planit të integritetit të Bashkisë Sarandë 2026-2028".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 7 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tetë të rendit të ditës: **P/vendim** " Miratim i korrigjimit të gabimeve materiale".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 8 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimet një nga një

Miratohen me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës **Informacion për masat e marra për fillimin e vitit shkollor 2025-2026.**

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 9 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Asaf Stroka: Ekzekutivi mund të bëjë një informacion të shkurtër për mediat, po patjetër edhe për publikun.

Teuta Maze: Ne sot kemi paraqitur planin për periudhën 2026-2028, si dhe masat që kemi marrë për këtë vit të ri shkollor 2025-2026, për të gjitha godinat që i përkasin Bashkisë Sarandë: kopshte dhe terrene. Janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të filluar mësimin në datën 8 shtator dhe për përmirësimin e kushteve të vitit të ri akademik 2025-2026.Siç jemi të gjithë në dijeni, të treja shkollat e Ksamilit janë përfunduar dhe kalimi është bërë komplet. Gjithashtu, në të gjitha godinat e tjera, si në Ksamil, Çukë, Berdenesh dhe Gjashtë, është përfunduar fasada e godinave. Sistemi "kapot" është realizuar për çdo objekt, pra për 24 objekte të kësaj zone që përmban Bashkia Sarandë.Janë marrë gjithashtu masa për dezinfektimin, mirëmbajtjen hidraulike dhe elektrike. Një grup është akoma sot në terren dhe po merret me të gjitha meremetimet e vogla, në mënyrë që të jenë të gatshme për datën 8 shtator. Nëse dikush ka ndonjë pyetje ose kërkon informacion të mëtejshëm, mund t'i përgjigjemi.

Kevin Alikaj : Faleminderit. Po, kjo është vetëm një pjesë e situatës së institucioneve arsimore. Të gjithë jemi në vrap, por kur shikojmë përpara shkollave ku fëmijët presin të futen, situata është e vështirë; ata rrinë si në mesjetë në anë të rrugës.A nuk mund të krijohet një tendë afër këtyre institucioneve? Nuk mjafton të presim vetëm masat e sigurisë që ofrojnë punonjësit e gardës; është e nevojshme që bashkia të marrë masat për mbrojtjen e nxënësve dhe për organizimin e qarkullimit rrugor. Kjo vlen veçanërisht për shkollën "9 Tetori" dhe shkollën "Adem Sheme".Bashkia duhet të kujdeset për pjesën e qarkullimit rrugor, sepse nuk mund të mbështetemi vetëm te policia për sigurinë e nxënësve gjatë daljes nga shkollat. Duhet të vendosen sensë kalimi dhe masa të tjera që sigurojnë lëvizjen e sigurt, sepse fëmijët nuk mund të rrinë të papenguar ndërkohë që qytetarët kalojnë rrugën. Në të dy këto institucione ka probleme të shumta dhe janë regjistruar edhe aksidente.

Dafina Allkushi:Për pjesën e arsimit, do të doja të falënderoja ekzekutivin për masat e marra në shkollën ku ne punojmë. Kemi filluar një vit të ri shkollor në kushte shumë më të mira se vitin e kaluar.Ndërkohë, një problem i madh për të gjithë zonën që unë përfaqësoj lidhet me punimet e

kanalizimeve të ujit që kanë nisur në muajin maj. Përveç se disa rrugë të ndërtuara më parë u shkatërruan, kanë mbetur gropa të mëdha dhe tuba të ngritur në ajër, si antena, pa asnjë masë sigurie. Që nga maji deri tani, kur mbaron sezoni, nuk shohim asnjë aktivitet të vazhdueshëm, as të paktën masa sigurie për kalimtarët apo automjetet.Nuk e di se çfarë preventimi ndiqet nga ekzekutivi në këtë rast, por për ne këshilltarët është shqetësuese të miratojmë fonde për projekte që nuk kanë progres. Ky shqetësim është i madh për banorët e zonës. Nëse projekti nuk kishte perspektivë, nuk duhej të fillonte, por të fillosh një projekt në maj dhe deri në fund të gushtit të mos ketë asnjë hap të ri dhe të krijojë vetëm pengesa është problematik.Situata është edhe më e ndjeshme duke pasur parasysh që turizmi po zhvillohet edhe në zonat periferike. Tani, fëmijët duhet të përdorin rrugën ku kalojnë automjetet, pasi trotuaret janë të prishura dhe gropat e hapura përbëjnë rrezik, veçanërisht me fillimin e shkollës pas një jave.Për këto arsye, do të dëshiroja të dinim se çfarë mund të na thoni për ecurinë e këtij projekti.

Asaf Stroka: Faleminderit zonja Allkushi. Siç propozuam, sekretaria e këshillit do të marrë masat për të kërkuar informacion të detajuar. Kjo pikë do të jetë e para në rendin e ditës në mbledhjen e ardhshme. Personat që ligji ngarkon për t'u përgjigjur dhe për të dhënë llogari për situatën e krijuar duhet të jenë prezent në mbledhjen e këshillit.

Faleminderit të gjithëve. Nëse nuk ka ndonjë shqetësim tjetër, duke i falënderuar për pjesëmarrjen, mbyllim mbledhjen.

Asaf Stroka : Duke ju falenderuar , e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Ky proçesverbal mbyllet me nr.rendor 6 (gjashtë) fletë, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe komisioni i verifikimit të procesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Valbona Vasili

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

1.	Kryetar i Këshillit Bashkiak :	Asaf Stroka
2.	Zëvendëskryetar i Këshillit :	Lindita Kondi
3.	Zëvendëskryetar i Këshillit :	Klejdjan Murtaj
4.	Zëvendëskryetar i Këshillit :	Bejdo Çela
5.	Partia Republikane Shqiptare :	Përparim Ahmeti
6.	Fryma e Re Demokratike:	Ilir Gërdhuqi
7.	Kryetar i Grupit Bashkë Fitojmë:	Shpëtim Ahmeti
8.	Kryetar i Grupit Partia Demokratike:	Vesel Koçiu
9.	Aleanca Arbnore Kombëtare:	Xhino Jaçaj
10.	Partia Lëvizja e Legalitetit:	Kevin Alikaj